



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 6 nëntor 2015
Nr. ref.:RK 856/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI61/15

Parashtrues

Islam Krasniqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të
Kosovës, A. A. nr. 2/2014, të 21 shkurtit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Islam Krasniqi nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, A. A. nr. 2/2014, të 21 shkurtit 2014. Aktgjykimi i kontestuar është pranuar nga parashtruesi më 14 mars 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, A. A. nr. 2/2014, të 21 shkurtit 2014.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 maj 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI61/15, caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI61/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
7. Më 23 korrik 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Nga një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë. Gjykata, po ashtu, kërkoi nga parashtruesi dhe nga Gjykata Themelore në Prishtinë të dorëzojnë dëshmi për datën e pranimit të vendimit të kontestuar nga parashtruesi.
8. Më 24 korrik 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi në Gjykatë dëshminë (fletëkthesën) që tregon datën e pranimit nga parashtruesi të aktgjykimit të kontestuar.
9. Më 10 shtator 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 8 shkurt 2010, parashtruesi kishte themeluar marrëdhënie pune me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës. Ndërkohë, parashtruesi ishte akuzuar nga eprorët dhe nga kolegët e tij për moskryerje të detyrave të punës dhe për sjellje të këqija. Nga shkresat e lëndës rezultoi se atij i ishin shqiptuar edhe disa vërejtje gojore dhe me shkrim (Nr. 574/03, më 4 qershor 2010, dhe Nr. 136/2012, më 9 mars 2012) nga eprorët e tij.

11. Më 10 maj 2012, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme mori Vendimin, Nr. 313/12 për ndërprerje të marrëdhënies së punës ndërmjet parashtruesit, si punonjës, dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme si punëdhënëse. Komisioni Disiplinor arsyetoi se parashtruesi, edhe përkundër vërejtjeve me shkrim nga eprorët e tij, kishte vazhduar me sjellje të këqija, me moskryerje të detyrave të punës, me shantazhe dhe me kërcënime fizike.
12. Komisioni Disiplinor, ndër të tjera, kishte arsyetuar:

“Në bazë të deklaratave dhe shkresave të ndryshme të dërguara në adresime të ndryshme shihet se (parashtruesi) ka bërë: shpifje, fyerje, etiketime, shantazhe ndaj kolegëve të punës, eprorëve dhe institucionit ku punon dhe nuk ka pasur asnjë argument për ta bindur Komisionin Disiplinor lidhur me pretendimet e tij”.
13. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi u ankua te Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
14. Më 13 qershor 2012, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me Vendimin, Nr. 422/2012, refuzoi ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi vendimin e Komisionit Disiplinor.
15. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi u ankua te Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPMK). Parashtruesi, ndër të tjera, kishte pretenduar se eprorët e tij janë marrë me shantazhe dhe me shpifje, kishte kërkuar kthim pa diskriminim në vendin e tij të punës dhe kishte kërkuar kompensim për kushtet e vështira dhe për rrezikshmërinë që karakterizonte vendin e tij të punës.
16. Më 12 korrik, 2012 KPMK-ja, me Vendimin Nr. 1166 - 02/159/2012 refuzoi ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi vendimet e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe të Komisionit Disiplinor. KPMK-ja, ndër të tjera, arsyetoi se parashtruesi ishte graduar në pozitë dhe pagë si masë stimuluese porse, edhe përkundër këtij avancimi ai kishte vazhduar me sjellje të këqija dhe me moskryerje të detyrave të punës.
17. KPMK-ja në vendimin e lartpërmendur, ndër të tjera, arsyetoi:

“Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesit i është ngritur koeficienti nga 5 në 6, por i njëjti në vazhdimësi ka bërë shkelje të detyrave të punës dhe për sjelljet e tija disa herë i është dhënë vërejtje me gojë dhe me shkrim nga mbikëqyrësit, prandaj SP duke u bazuar Ligjin, Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 51 paragr. 4, kërkon që ankuesi të ju nënshtrohet masave disiplinore, për shkak të shkeljes të dispozitës të nenit 56 paragr. 1.4, dhe duke u bazuar në nenin 66 paragr. 4.3 Komisioni Disiplinor i shqipton masën disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, pasi që masat më të lehta të dhëna nga mbikëqyrësit nuk kanë pasur efekt përmirësues .
18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi u ankua kundër vendimit të KPMK-së në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative.

Parashtruesi kishte pretenduar se KMPK-ja kishte marrë vendim të kundërligjshëm pa praninë e tij, se janë shqyrtuar vetëm provat e palës kundërshtare dhe se atij nuk i ishte dhënë mundësia për të paraqitur prova të reja.

19. Më 22 tetor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me Aktgjykimin, A. nr. 892/2012 refuzoi, si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit. Gjykata Themelore, ndër të tjera, arsyetoi se KPMK-ja nuk është e detyruar të mbajë seancë publike, përveç në rastet kur palët e kërkojnë me shkrim.

20. Gjykata Themelore në Prishtinë në vendimin e lartpërmendur, ndër të tjera, arsyetoi:

"... Gjykata iu referua edhe Rregullores nr. 02/2011, për rregullat dhe procedurat e ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 4.2.6, i cili përcakton se "kolegji do të shqyrtoj ankesën dhe do të marrë vendim në bazë të materialit me shkrim. Nëse aty ka konflikt të faktit material, apo nëse një palë e kërkon atë, këshilli do të autorizojë sekretariatit e tij që të organizojë seancë publike".

Sipas dispozitave të lart cituara ligjore, i padituri KPMSHCK, nuk ka qenë i detyruar të mbajë seancë publike, përjashtimisht vetëm atëherë kur palët kërkojnë një gjë të tillë me shkrim".

21. Më 22 nëntor 2013, parashtruesi u ankua në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Parashtruesi, në thelb, u ankua se Gjykata e faktit ka qenë e njëanshme në pranimin e provave dhe se ai nuk kishte shkelur rregullat e punës siç përcaktohet me vendimet e komisioneve të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe KPMK-së.

22. Më 21 shkurt 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktgjykimin A. A. nr. 2/2014, refuzoi, si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Gjykata e Apelit i karakterizoi pretendimet e parashtruesit të pabazuara, të përgjithësuara dhe jokonkrete.

Pretendimet e parashtruesit

23. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që vendimet e gjykatave të rregullta, të KPMK-së dhe të komisioneve disiplinore, t'i shpallë jokushtetuese dhe të jashtëligjshme, sepse ndërprerja e marrëdhënies së punës përbën shkelje të të drejtave të njeriut, diskriminim, gjykim të padrejtë, ndalim të shprehjes së lirë, ndalim të qasjes në dokumente publike dhe cenim të së drejtës në karrierë. Parashtruesi i referohet nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 40 [Liria e Shprehjes], nenit 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës.

24. Parashtruesi pretendon se nuk është ankuar në Gjykatën Supreme të Kosovës për shkak të gabimeve të avokatit të tij dhe për shkak të papërgjegjësisë së Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

27. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

28. Gjykata merr parasysh edhe rregullin 36 1 (c) të Rregullores së punës, që përcakton:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(c) kërkesa parashtrohet brenda 4 (katër) muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi...”.

29. Gjykata konsideron se parashtruesi për realizimin e të drejtave të tij kushtetuese duhet t'i shterojë mjetet juridike tek organet kompetente, dhe vetëm pas kryerjes së këtyre veprimeve, gjegjësisht pas shterjes së mjeteve juridike, ai mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese brenda afatit prej 4 (katër) muajsh të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit, dhe të specifikuar më tej me Rregullin 36 1 (c) të Rregullores së punës. (Shih rastin Nr. KI91/13, parashtrues të kërkesës *Shpend Zajmi, Avni Kryeziu dhe 19 të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 tetorit 2013).

30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi ka pranuar vendimin e fundit të kontestuar më 14 mars 2014, derisa kërkesa është dorëzuar më 13 maj 2015, përkatësisht 10 (dhjetë) muaj pas afatit të përcaktuar me ligj.

31. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri ligjore duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (Shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendim i 25

gushtit 2005 dhe shih, *mutatis mutandis*, Rastin nr. KI140/13, parashtrues *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 marsit 2014).

32. Gjykata, po ashtu vëren se parashtruesi fajëson avokatin e tij për mosrespektim të afatit ligjor, dhe m'u për këtë arsye është ankuar në Odën e Avokatëve, çka në të vërtetë nuk përbën argument të vlefshëm për shqyrtim para Gjykatës Kushtetuese; aq më tepër, kur Komisioni i Ankesave i Odës së Avokatëve kishte konstatuar se avokati i parashtruesit nuk kishte shkelur detyrat apo kodin e etikës që ndërlidhen me punën e tij si avokat.
33. Gjykata thekson, se sjellja para gjykatave e avokatit apo e përfaqësuesit të autorizuar nga vetë parashtruesi është përgjegjësi e parashtruesit. Çfarëdo veprimi ose mosveprimi procedural nga përfaqësuesi i atribuohet parashtruesit të kërkesës (Shih *Bekauri kundër Gjeorgjisë*, Nr. 14102/02 GJEDNJ, aktgjykim i 10 prillit 2012, paragrafët 22-25; dhe shih, *mutatis mutandis*, Rasti nr. KI02/10, Aktvendim për papranueshmëri, *Roland Bartecko*, paragrafët 25-28, 21 mars 2011 dhe *Migliore dhe të tjerët kundër Italisë*, Nr. 58511/13 GJEDNJ, aktvendim i 27 janarit 2014).
34. Në përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa është e paafatshme dhe duhet shpallur e papranueshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 49 të Ligjit si dhe në pajtim me Rregullin 36 1 (c) të Rregullores së punës, më 10 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi